VENDIM
Nr. 163, datë 12.10.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të seksionit II, neni 22, 23 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ERE ka kompetencën për të hartuar licencën e tregtimit të gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti